



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 13 NËNTOR 2018**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 13. NOVEMBRA 2018. GODINE**

**NËNTOR - NOVEMBAR
2018**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi dhe miratimi i pakos së ligjeve për sundim të ligjit dhe agjendën integruese evropiane

Dnevni red

1. Razmatranje i usvajanje paketa zakona o vladavini zakona i evropske agende za integraciju

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Në sallë janë 41 deputetë,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 12. 11. 2018, me kërkesë të kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj.

Fillojmë me rendin e ditës, si në vijim:

1. Shqyrtimi i pakos së ligjeve për sundim të ligjit dhe agjendën integruese evropiane

Fjalën për procedurë e ka kërkuar zoti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo është një seancë e jashtëzakonshme, e ftuar nga kryeministri i Republikës së Kosovës.

Ne dje në Komisionin për Legjislacion kemi pasur një takim me kryeministrin dhe kemi pasur të paktën një pajtim, meqenëse kërkesa për seancë të jashtëzakonshme nuk është shumë e saktë. Ne kemi kërkuar sqarim se çka po kërkon ai dhe na është thënë që kërkon të trajtohen në leximin e dytë katër ligje që kanë të bëjnë me agjendën evropiane të integrameve të reformave.

Dhe, ne kemi thënë dhe kemi konkluduar bashkërisht se kryeministri nuk mund të thërrasë seancë të jashtëzakonshme për lexim të dytë, është jashtë kompetencave të kryeministrit dhe konsiderohet shkelje e autoriteteve dhe përgjegjësive kushtetuese të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe për pasojë kemi kërkuar që kryeministri të njoftoj Kryesinë e Kuvendit dhe kryetarin e Kuvendit që të tërhiqet nga seanca dhe ai është pajtuar që do të tërhiqet nga seanca dhe në të njëjtën kohë Komisioni për Legjislacion do t'i shqyrtojë me prioritet këto projektligje, do t'i propozojë amendamentet të cilat janë përgatitur dhe do të kërkojë nga komisionet tjera që mundësisht t'i shqyrtojnë me prioritet.

Në të njëjtën kohë, Komisioni ka marrë vendim që t'i drejtohet me një letër Kryesisë së Kuvendit, me të cilën e njofton për rëndësinë e këtyre projektligjeve dhe e lut që mundësisht ta trajtojë në një kohë sa më të shkurtër të mundshëm në një seancë që të aprovohen këto projektligje.

Por, konkludimi kryesor i Komisionit bashkërisht me Qeverinë dhe kryeministrin është: Kryeministri në kompetencat e tij nuk mund të thërrasë seancë të jashtëzakonshme për lexim të dytë të ligjeve. Është kompetencë ekskluzive e Kuvendit. Pra, demokracia funksionon kështu,

kryeministri propozon, ka të drejtën e propozimit të ligjeve, ka të drejtën edhe të thërrasë seanca të jashtëzakonshme, por jo seancë të jashtëzakonshme për lexim të dytë të projektligjeve.

Prandaj, kjo seancë sot nuk ka objekt dhe nuk duhet të mbahet si e tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit për Legjislacion.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Po mundohem t'i përmend disa çështje që kanë të bëjnë me seancën e sotme.

1. Përdorimi i standardeve të dyfishta në kohën kur opozita kërkoi seancë të jashtëzakonshme për ndalimin e ndërmarrjes së rrezikshme të presidentit Thaçi as nuk u hap seanca, sepse nuk ishin në sallë 61 deputetë, ndërsa sot me 40 e ca e hapët seancën.

Pra, kjo dëshmon që kur ju përshtatet e hapni, kur s'ju përshtatet nuk e hapni seancën dhe natyrisht kjo është shumë problematike, sepse Kuvendi nuk është i koalicionit, por është i të gjithë deputetëve të Kuvendit, sepse ne jemi këtu përfaqësues të popullit.

2. Ka një mungesë të vazhdueshëm të planifikimit dhe përgatitjes, madje kjo është shndërruar si sëmundje e pashërueshme e kësaj Qeveria, por edhe e kryetarit të Kuvendit.

Në vend që sot ta kishim një koordinim, ose të vinim këtu me një koordinim ndërmjet Qeverisë dhe Kuvendit, sot jemi në seancë me këtë rend dite, ku thuhet: Shqyrtimi dhe miratimi i paketës së ligjeve, as nuk është shkruar mirë, që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit dhe agjendën integruese evropiane. Cilat janë ato? Cilat janë ato projektligje që ne sot duhet t'i shqyrtojmë këtu? A kanë emra? Ne si Komision mund t'i dimë, sepse i kemi pasur informacionet, por janë 120 deputetë në Kuvend të Kosovës, nuk janë 11 sa i ka Komisioni për Legjislacion. Pra, kjo është komplet joserioze.

Çështja tjetër, është e vërtetë që sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës kryeministri ka të drejtë të thërrasë seancë të jashtëzakonshme, por ne konsiderojmë që Qeveria nuk ka të drejtë që t'i kërkojë Kuvendit kohë të caktuar sikur aktualisht për votim në shqyrtim të dytë të projektligjeve që janë pronë e Kuvendit. Në momentin kur Qeveria e procedon në Kuvend një projektligj, ai është pronë e Kuvendit dhe Qeveria nuk mund të ndërhyjë në punën e Kuvendit dhe t'i tregojë se kur duhet t'i miratojë apo jo ato projektligje. Kjo është shkelje edhe e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e ndarjes së pushteteve, dhe është shndërrua dukuri kjo ndërhyrja në pushtete. Herë ndërhyjnë presidenti në Qeveri, herë presidenti në Kuvend, herë në sistemin e drejtësisë, herë kryetari i Kuvendit në Qeveri, i duket vetja si kryeministër, dhe tash. Domethënë, ka një ndërhyrje të vazhdueshme që po bëhet në këto pushtetet siç janë të ndara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Dhe, tjetra është që Komisioni për Legjislacion, siç e tha edhe zoti Gashi, dje ka diskutuar. Ne e kemi pasur një qëndrim të kryeministrit pas kërkesës që ia kemi bërë si Komision, tërhiqemi ka thënë nga kërkesa për seancë të jashtëzakonshme, sepse nuk është e rregullt dhe nuk është kushtetuese kjo që është adresuar dhe Komisioni për Legjislacion i ka bërë dy shkresa.

Shkresa e parë për komisionet funksionale, Komisionin për Integritet, Komisionin për Buxhet dhe Komisionin për të Drejtat dhe Komunitetet, ka kërkuar që katër projektligje që janë projektligjet, e që po ju tregoj, sepse deputetët mund të mos e dinë, sepse nuk e kanë në rend të dite, Projektligji për mbrojtjen e sinjalizuesve, Projektligji për zgjerimin e kompetencave për konfiskimin e pasurisë dhe përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe Draft-Kodi Penal.

Këto janë prioritet absolut dhe ne i kemi përfunduar si komision të gjitha këto projektligje. Dje ua kemi dorëzuar komisioneve funksionale, ato pritet që sot të mblidhen, prandaj seanca e sotme nuk ka objekt dhe nuk mund të shqyrtojmë asgjë për sa kohë ne nuk kemi materiale. Dhe, tjetra, sot është dashur të mbahet një seancë e jashtëzakonshme për skandalet e presidentit Thaçi. Pra, kjo tendenca që ta zëvendësojë Gjermaninë me Rusinë, neve duhet të na shqetësojë kjo aventurë e Hashim Thaçit. Është skandal çfarë po bën ai si President i vendit, por këtë ndoshta do të kemi mundësinë ta diskutojmë të premtën, sepse kjo është e papranueshme çka po bën ai si president, duke tentuar ta zëvendësojë apo të krijojë marrëdhënie të re me Serbinë dhe Rusinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë pajtohem që është gabim procedural, sepse është ndonjë Parlament që i ka 60 deputetë që i duhet kuorumi për ta filluar seancën, por Parlamentet e krejt Evropës, po e marr parasysh edhe Britaninë e Madhe, asnjëri s'ka nevojë për kuorum për ta filluar seancën. Kuorumi duhet të jetë në votim, deputetët qëndrojnë për çështjet që janë të interesuar të diskutojnë dhe të debatojnë, për çështjet e tjera nuk qëndrojnë.

Por, sidoqoftë, këto po ndodhin te ne, interpretimi mund të bëhet i gjithfarshëm. I kemi rregullat siç e dini që ne kemi të drejtë të bëjmë mocion edhe në seancë, por duhet të ketë kuorum për t'u votuar mocioni. Edhe për të filluar një seancë tjetër, me një rend tjetër të ditës, edhe për të futur diçka në rend të ditës. Kështu që kjo është e vërteta, por zonja Haxhiu ju keni qenë në mbledhjen e Kryesisë dhe ka një procesverbal të mbledhjes së Kryesisë, ku pikërisht janë thirrur ata që e kanë thirrur mbledhjen dhe që kanë kërkuar në emër të Kushtetutës dhe ju asnjë fjalë s'e keni folur për ta kundërshtuar këtë praktikë. Prandaj, tash është vonë kështu që unë respekt të seancës kam qëndruar, kam ardhur sot për të marrë pjesë në seancë. Tani po ua jap fjalën kryetarëve të grupeve parlamentare siç janë paraqitur me radhë. Së pari zotit Memli Krasniqi, pastaj të përgatiten Ahmet Isufi e Bilall Sherifi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Realisht që ta thjeshtojmë pak situatën, ne sot kemi ardhur këtu për shkak të procedurave. Krejt ne q jemi në këtë sallë e dimë, edhe ata deputetë që s'kanë ardhur, që sot seanca nuk mbahet, sepse ne jemi pajtuar dje që kjo seancë të mos mbahet, por për shkak të interpretimeve të Rregullores, e të procedurave ne kemi përfunduar sot këtu. Në orën 15:15 minuta kryeministri dje ka dërguar letër pas konsultimeve dhe marrëveshjes me Komisionin për Legjislacion që kërkon shtyrjen e kësaj seance, duke qenë se janë pajtuar që seancën pastaj ta ftojme nëpërmjet Kryesisë, kurdo që Komisioni për Legjislacion e konstaton që e kanë përfunduar punët në ato projektligje prioritare, të cilat janë në lexim të dytë.

Dhe, do të ishte e rrugës më së lehti që ne dje ta thërrisnim edhe një herë Kryesinë, ose të konsultoheshin anëtarët e Kryesisë që të mos vinim sot fare këtu, duke e ditur që sot kemi ardhur për të thënë që seanca nuk mbahet, ose dikush ta keqpërdorë këtë minutazh për të bërë politikë. Kryeministri e ka ftuar një seancë, unë besoj prej vullnetit të mirë, duke qenë se ato me të vërtetë janë projektligje, të cilat jemi vonuar për t'i aprovuar dhe në këtë kuadër ka qenë një kërkesë e tij, por që po pajtohemi është dashur që ndoshta të vinte në një formë tjetër. Tashmë, kjo pajtueshmëri ekziston. Komisioni për Legjislacion e ka përfunduar punën me katër projektligjet që u përmendën, mbeten edhe komisionet tjera të përhershme për ta kryer punën e tyre, shpresojmë sot apo nesër, dhe që ndoshta gjatë kësaj jave ta mbajmë seancën dhe që t'i aprovojmë këto projektligje dhe ndonjë tjetër nëse veç mund të mbahet.

Andaj, unë shpresoj që sot mund ta konstatojmë që është kërkuar shtyrja e kësaj seance nga kryeministri, që fillimisht e ka kërkuar mbajtjen e saj dhe që pastaj sot gjatë ditës apo nesër të merremi vesh kur mund të ftohet një seancë tjetër, e cila realisht ka subjekt dhe që ka rend dite të saktë dhe që dihet për cilat projektligje po vijmë.

Sa u përket aspekteve procedurale, kanë kaluar shumë muaj që ne e kemi në procedurën e leximit të dytë Rregulloren e punës së Kuvendit, do të ishte mirë që më përfundimisht të merremi vesh dhe ta futim në rend dite, t'i bëjmë amendamentet apo plotësim-ndryshimet e nevojshme dhe pastaj të mos kemi paqartësi nëse duhet të fillojë një seancë me kuorum apo pa kuorum, a duhet ftuar një mbledhje në këtë apo në atë rast, po edhe në rastin sikur ky kur sponsorizuesi i kërkesës ndërkohë kërkon shtyrjen e seancës, a duhet të mblidhemi këtu formalisht sa për të thënë që s'po mbajmë seancë, apo s'do të kishte pasur nevojë të mblidhemi hiç, çka unë mendoj se do të ishte më e drejtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Dardan Sejdiu, në emër të PSD-së.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit!

Sinqerisht, është e paqartë për secilin prej deputetëve këtu sot në sallë që jemi, përveç atyre që keni qenë në mbledhje të komisionit dje, se për çfarë jemi mbledhur, cilat janë ato ligje. Disa, siç

tha edhe deputetja Haxhiu, mund t'i dinë, disa gjithashtu mund ta dinë për vonesën deri tash pse s'kemi ardhur në lexim të dytë, por besoj që nuk është në rregull, e besa as korrekte, që të përfundojmë në seancë nëse ekziston një kërkesë për shtyrje të seancës nga ai i cili e ka ftuar seancën.

Rrjedhimisht, ne si grup parlamentar kemi ardhur këtu, sepse s'kemi pasur njoftim për shtyrje të seancës, por sot nuk po shoh që kemi ndonjë arsye për të qëndruar më shumë në sallë, kështu që ju lus si kryesues ta ndërpritni seancën dhe të koordinohen grupet, komisioni, Kryesia, kryeministri dhe të vazhdojmë me punë nëse ka diçka që duhet trajtuar këtu në Kuvend.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligjet që po përmenden kërkojnë azhuritet për shkak se pikërisht lidhen me rendin dhe ligjin dhe është kërkesë edhe e mëhershme që këto ligje sa më shpejt të amendamentohen dhe të kalojnë në seancë plenare. Kërkesa e kryeministrit për seancë të jashtëzakonisht e ka pasur pikërisht këtë motiv dhe duhet kuptuar jo si ndërhyrje, por si vullnet i mirë të Qeverisë që të kalohen sa më shpejt projektligjet të cilat Qeveria veç i ka sjellë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Kemi edhe projektligje të tjera që po neglizhohen dhe në njëfarë mënyre faji është i Kuvendit, që s'po i kryen nëpër komisione punët e veta ashtu siç duhet dhe të mos ketë nevojë për seanca të jashtëzakonshme. Njëkohësisht, Komisioni për Legjislacion i ka kryer obligimet e veta ndaj këtyre projektligjeve. Janë edhe tri komisione të tjera, le të mblidhen në afatin sa më të shpejtë, le ta kryejnë punën e vet dhe mund t'i aprovojmë. Në fund të fundit, Kosova ka nevojë t'i kryejë obligimet e veta sa më shpejt që është e mundur, e sidomos Parlamenti në këtë rast të jetë sa më aktiv, në mënyrë që të mos ankohe mi pastaj se s'po na plotësohen disa kërkesa që janë para bashkësisë ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të nderuar,

Meqë kryesuesi e përmendi mbledhjen e Kryesisë, më duhet të nënvizoj që unë në mbledhjen e Kryesisë dje kam theksuar që kërkesa duhet të jetë më specifike dhe ligjet që do të duhej sot të shqyrtohen të emërohen se cilat janë ato ligje, sepse është e paqartë nga definicioni i përgjithshëm "ligjet që kanë të bëjnë me agjendën evropiane" dhe ju Kryesia më keni kundërshtuar se nuk ka nevojë kryetari e kryeministri në kërkesën e tij ka të drejtë të ftojë seancë

dhe nuk ka nevojë, apo është e mjaftueshme kjo kërkesë siç e ka bërë ai, në mënyrë që të ftohet seanca.

Pra, jo që askush nuk ka pasur kundërshtime rreth mënyrës dhe përmbajtjes së kërkesës për seancë të jashtëzakonshme, por kjo le të mbetet, në fund të fundit s'është aq e rëndësishme ajo. Ajo që desha të them është kjo që nëse shpresoj që nuk do të më hidhërohen ata të OJQ-ve me atë emërtimin Demokracia në Veprim, kjo seancë i ngjet pak a shumë kësaj - Demokracisë në Veprim, ku nuk respektohet strikt procedura, pra është ftuar seanca dhe tani nuk mund të mbahet, 'çthirret' edhe pse e kemi ditur se nuk do të mbahet. Nuk është dashur për mendimin tim që të vijmë deri te ky ushtrim i domosdoshmërisë, që të vijmë këtu për të konstatuar se nuk e kemi pakon e ligjeve për t'i shqyrtuar, sepse janë në komisione.

Një gjë e tillë ka mundur të bëhet duke e shkëmbyer edhe një letër me kryeministrin. Nëse e keni marrë një, keni mundur t'ia dërgoni edhe një, dhe të kërkonit edhe një letër nga ai që të kërkojë tërheqje, sepse në marrëveshje me kryeministrin në Komision dje kemi pasur një marrëveshje që ai të bëjë tërheqjen e kërkesës për seancë të jashtëzakonshme, në mënyrë që sot dhe nesër të përfundojnë punët në komisione dhe kështu të ftohet seanca kur ligjet do të mund të kalojnë.

Nuk është në rregull dhe nuk ka qenë korrekte. Keni mundur si Administratë dhe si Kryesi ta keni një komunikim më intensive me kryeministrin dhe me Qeverinë dhe sot nuk do të ishim këtu kot, për të bërë siç u tha këtu propagandë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë mendoj që edhe Kryesia, edhe Administrata edhe deputetët nuk janë emergjencë, as në gjendje të jashtëzakonshme të luftës, por as s'kanë ndonjë emergjencë që të rrinë kujdestarë sa herë të vijnë letra pas dreke dhe para dreke për t'i shqyrtuar. Para dreke t'u thuhet deputetëve "hajdeni se ka seancë", e pas drekës t'u thuhet "jo s'paska sot".

E dyta, unë thashë kam ndenjtur për seancën, sepse Kryesia ka marrë vendim dhe edhe ju që jeni këtu në mirëkuptim të kërkesës së kryeministrit dhe vendimit të Kryesisë, jeni në seancë. Këtë po e kuptoj kështu. Edhe ashtu s'paska kuorum dhe mund ta ndërpresim seancën, por s'ka pasur kuptim të mos vijmë, sepse i kemi ftuar deputetët, e kemi një vendim të Kryesisë dhe duhet të mbajmë mbledhje.

Zoti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Pak a shumë e thatë ju këtë të fundit çka mendova ta them. Kuvendi i Republikës së Kosovës funksionon me dokumente dhe me shkresa. Ne shkresën e kemi për seancë sot dhe prania jonë është mbi bazën e asaj shkrese, ndërsa realisht gjendja çfarë është e tregon pasqyrën reale të moskoordinimit institucional, atë që po e theksojmë çdo ditë. Jo vetëm moskoordinimit, por

papërgjegjesisë institucionale, nuk po them paditurisë institucionale, sepse ka rregulla, ka procedura dhe praktika çfarë ka ndërtuar edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës në raport me Qeverinë dhe ndërtimin e legjislacionit.

Andaj, kjo pozitë çfarë jemi sot tregon arsyeshmërinë më të madhe pse Kuvendi është jofunksional dhe pse kjo mazhorancë e ka krijuar Kuvendin, apo më mirë të them duke tentuar të instalojë një logjikë, e cila e vë në jofunksion total edhe demokracinë në vend.

Unë ju kisha lutur që raste të tilla të mos përsëriten, sepse me të vërtetë është precedent i keq raporti i tillë dhe vënia e deputetëve para një akti të kryer kur me ne krijohet pasqyra në raport me qytetarët e vendit, “shikojeni çfarë është gjendja në Kuvendin e Republikës së Kosovës”. Kështu që kjo është përgjegjësi e atyre që e kanë thirrur këtë seancë, është papërgjegjësi e Kryesisë që e ka lejuar një materie të tillë pa materie të vihet në seancë plenare dhe ky është tregues i qartë që vendi është në krizë të thellë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Të gjithë kemi qenë në mbledhje, asnjë grup parlamentar s’ka qenë i papërfaqësuar, përjashto PSD-në, që Dardani ka pasur një takim tjetër dhe ka dalë para kohe.

Zonja Albulena Haxhiu e ka prapë fjalën në emër të grupit parlamentar.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Po mundohem shpejt vetëm disa çështje. E para, është e vërtetë ne kemi qenë dje në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit. Interpretimi nga kryetari i Kuvendit që na ka ardhur është që kryeministri ka të drejtë të thërrasë seancë të jashtëzakonshme dhe ne nuk mund ta ndalim. Kështu ka qenë, pak a shumë. Dhe, ne si “Vetëvendosje” kemi thënë: “mirë, ne do të jemi aty, pavarësisht votës tonë për projektligjet”. Pra, ne jemi këtu, siç po na shihni.

Çështja tjetër, kryeministri ka pasur të drejtë që ta thërrasë kryetarin e Kuvendit, apo me anë të letrës t’i kërkojë që këto projektligje duhet të përshpejtohen, por jo që ai të bëjë kërkesë për seancë të jashtëzakonshme. Tjetra, sipas informacioneve që i kam, letra e kryeministrit ka ardhur dje në Kuvend para orës 16:00.

Këtu ka një problem dhe një konflikt apo moskoordinim të qëllimshëm ndërmjet kryetarit të Kuvendit dhe në këtë rast kryeministrit Haradinaj, sepse ne në orën 15:30 jemi mbledhur bashkë me sekretarin e Kuvendit, i kemi kërkuar që kjo seancë të mos mbahet, të njoftohen deputetët e Kuvendit, sepse është tallje me neve që të na thërrisni kur nuk kemi se për çka të diskutojmë. Mirëpo, kryetari i Kuvendit ka thënë “jo”. Prandaj, duhet thënë e vërteta.

Pra, kryetari i Kuvendit nuk ka lejuar, për çfarë qëllimi ai e di. Mirëpo, ka pasur një insistim të disa shefave të grupeve parlamentare, përkatësisht të përfaqësuesve që të njoftohen deputetët që

seanca e sotme nuk mbahet. Edhe tash kur ka pasur një kërkesë të kryeministrit për shtyrje, ndonëse në komision jemi dakorduar për tërheqje nga kjo seancë.

Edhe një herë, qëndrimi i “Vetëvendosjes” është njësoj dhe në linjë me atë të Komisionit për Legjislacion. Komisioni tashmë i ka shkruar Kryesisë për caktim të seancës për trajtimin e këtyre projektligjeve në shqyrtim të dytë, në anën tjetër, sipas informacioneve, disa komisione do të mbledhen sot, do t’i shqyrtojnë raportet, kur t’i kenë gati Kryesia duhet ta thërrasë seancën dhe ne do të jemi këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Së pari faleminderit dhe përshëndetje për partitë opozitare që kanë ardhur sot në seancë të jashtëzakonshme për ta shqyrtuar një “pamaterie”. Gjithë kjo prani, derisa e kanë ditur se nuk ka materie, atëherë pse kanë ardhur sot?

Derisa është në faqe të Kuvendit mbledhja për seancë plenare, qoftë e zakonshme apo e jashtëzakonshme, deputetët e kanë për obligim për të qenë. Mirëpo, duke e ditur bojkotimin që e kanë bërë deri sot, në këtë seancë që nuk ka brumë, nuk ka materie, të jetë gjithë kjo prani, vërtet po na vjen mirë. Mirëpo, nuk është obligim i deputetit që të vijë 10 minuta 15 minuta, Komisioni për Arsim dhe deri në orën 17:00 ka qenë në Kuvend, ata që kanë dashur të punojnë.

Por, nuk do të thotë që deputeti duhet të vijë vetëm atëherë kur e ngre një “pa çështje” ose “pa brumë”, sa për të thënë diçka. Po, në faqen e Kuvendit për secilin qytetar për secilin deputet ka qenë njoftimi që sot ka seancë, është fakt. Se a ka ardhur shkresa 15 para orës 16:00, apo para 15:00, me një fjalë është orar zyrtar dhe Qeveria Haradinaj nuk punon deri në 16:00, e që tjerat ndoshta zakonisht nuk kanë punuar as dy-tri orë, mirëpo edhe pas këtij orari punon.

Megjithatë, shkresa ka ardhur në afatin kur orar zyrtar, që është deri në orën 16:00. Vërtet është dashur që deputetët të njoftohen, mirëpo hajde po flasim sot, po diskutojmë shumë çështje të tjera, ndoshta dikë e ka marrë malli që të vijë e të diskutojë në materie “pa materie”.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti e ka kërkuar fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Më lejoni ta qartësoj që Grupi Parlamentar i LDK-së sot është në seancë në përputhje me qëndrimin tonë si parti, si grup parlamentar që mbështetim marrëveshjet ndërkombëtare dhe agjendën për integrim evropian.

Është e qartë që seanca nuk ka materie, substancë, dhe duhet të mbyllet, por ta ketë të qartë edhe deputetja parafolëse dhe të gjithë të tjerët se për këtë ne jemi sot në seancë. Ne kërkojmë që të ketë një koordinim më të mirë ndërmjet koalicionit qeverisës, Zyra e kryeministrit dhe Zyra e kryetarit të Kuvendit janë vetëm 20 metra larg njëra-tjetrës. Të mos i sjellim kështu deputetët në këtë situatë të pavolitshme kur duhet të vijnë në seancë dhe nuk ka se çfarë të shqyrtohet në seancë.

Unë kërkoj që të koordinoheni pak më mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe njëherë për njoftim: Kryesia e Kuvendit nuk merr urdhra nga komisionet. Të merremi vesh! As nga deputetët e veçantë. As nga kryeministri. As nga Qeveria. Kuvendi është institucioni kush do ta respektojë më i lartë i shtetit që i ka politikat e veta, e ka drejtimin e vet. Ka politika që kanë të bëjnë me miratimin e ligjeve dhe me çështje që i ka obligim si Parlament.

Seancën e kemi thirrur si Kryesi me kërkesë të kryeministrit të Kosovës dhe jemi në seancë. Konstatoj që seanca nuk ka qenë e përgatitur për t'u thirrur, edhe pse është bërë kërkesa dhe prandaj seancën e shpall të mbyllur. Seanca tjetër, qoftë për këtë çështje, qoftë për çështje të tjera, mund të thirret prapë edhe nga kryeministri, edhe nga deputetët.

Kjo seancë është e mbyllur. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*